



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Prilato Received/Delivry	20.05.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM&HUK	2960/2022		117



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.340/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-krjetar, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.340/2021 të datës 06.04.2022 dhe me numër A.nr.1208/2021 të datës 21.12.2021 të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar avokati me datë 06.04.2022, me adresë: për ankuesin

kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.340/2022 e datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

III. **MBETET** në fuqi Vendimi Nr.03/55 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.01.2022, ndërsa Ministria e Zhvillimit Ekonomik **Obligohet** që ankuesit t'ia bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive të pagave nga dita e shkarkimit deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi.

IV. **OBLIGOHET** Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë brenda afatit ligjor të bëjë sistemimin e ankuesit.

V. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme-Diasporë, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi sipas pikës II të Dispozitivit, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të tij.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

ARSYETIM

Ankuesi me Vendimin Nr.16/35 të datës 09.03.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka qenë i emëruar *Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal*, me mandat tre (3) vjeçar. Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 28.09.2020 ka nxjerrë Vendim Nr.12/33 që ankuesin nga pozita e *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal*, të **transferojë** në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, për periudhën kohore brenda mandatit të përcaktuar me Vendimin Nr.16/35 të datës 26.03.2018.

Bazuar në kërkesën e Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të datës 06.01.2021, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 42 dhe 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka nxjerrë Vendimin Nr.13/59 të datës 21.01.2021 për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit për katër (4) vite tjera, duke filluar nga data 10.03.2021.

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 13.10.2021, ka nxjerrë Vendimin Nr.34/39 të datës 13.10.2021 më të cilin ka shfuqizuar Vendimin Nr.13/59 të datës 21.01.2021, përmes të cilit ankuesit i ishte vazhduar mandati i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, me ç'rast të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës respektivisht mandati i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Kundër Vendimit Nr.34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesi fillimisht me datë 19.10.2021, ka parashtruar kërkesë për rikthim të ligjshmërisë pranë Ministrisë për Ekonomi. Pas heshtjes se kësaj të fundit, ankuesi me datë 08.11.2021, ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil, ky i fundit me Vendimin A.nr.908/2021 të datës 05.01.2022 ka anuluar Vendimin Nr.34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.

Duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil A.nr.908/2021 të datës 05.01.2022, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të datës 21.01.2022, ka nxjerrë Vendimin Nr.03/55 duke shfuqizuar Vendimin Nr.13/59 të datës 21.01.2021 të Qeverisë së Kosovës.

Për të njëjtën çështje me datë 21.12.2021 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil i Kosovës, ka pranuar ankesë me numër A.nr.1208/2021 me numër protokolli 6251/2021, kundër njoftimit të datës 18.11.2021 Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-DMZP/MPB, me pretendimin ankimore për rikthimin e tij në listën e pagave.

Ndërkohë nga i njëjti ankues është paranuor edhe ankesa me numër Anr.67/2022 me datë 26.01.2022 pas nxjerrës se Vendimin Nr.03/55, për të njëjtin objekt shqyrtimi në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, për çështjen juridike kundër Vendimit Nr.03/55 të datës 21.01.2022.

Me datë 15.02.2022 Kolegji i Këshillit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka nxjerrë Vendimin me numër Anr.1208/2021 duke pezulluar procedurën administrative të filluar sipas ankesës së datës 21.12.2021 deri në vendosjen e rastit të ankuesit sipas ankesës me numër Anr.67/2022 të datës 26.01.2022, kundër Vendimit të Qeverisë Nr.03/55 të datës 21.01.2022.

Ankuesi pas pranimit të Vendimit me numër Anr.67/2022 të datës 07.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 17.03.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 431-02 tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-DMZP, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit nga Prishtina, për emërimin e tij në pozitën e nivelit të mesëm drejtues, siç e përcakton nenin 42 paragrafin 4 dhe 8 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili bazohet dhe në konstatimet e Vendimit me numër Anr.67/2022 të datës 07.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës si në arsyetimin e këtij vendimi në faqen 4 dhe 5, me rastin e përfundimit të mandatit të tij, nga pozitë: Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, me Vendimin Nr.03/55 e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 21.01.2022.

Me datë 04.04.2022 zv.Drejtoresha e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB/DMZP, ka nxjerrë Aktin administrativ-sqarues me numër protokollit 431-02, lidhur me kërkesën e datës 17.03.2022 të ankuesit.

Ankuesi i pa kënaqur me Aktin administrativ sqarues të datë 04.04.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB/DMZP, me datë 06.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 1911/2022 e regjistruar me numër rendor A.nr.340/2022, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit nga Prishtina, të cilën ankesë e ka plotësuar me parashtresën e datës 12.04.2022 me numër protokollit 2031/2022, duke pretenduar që ti aprovohet ankesa si e bazuar për emërimin e ankuesit në një pozitë të nivelit të mesëm drejtues, pas mbarimit të mandati të tij nga pozita e kategorisë së lartë drejtuese, siç e përcakton nenin 42 paragrafin 8 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, duke u marrë për bazë standardin e vendimeve të Këshillit, si në arsyetimin e Vendimit me numër Anr.82/2022 të datës 28.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, si dhe Vendimin me numër Anr.67/2022 të datës 07.03.2022, duke cituar pjesën e vendimit të faqes 4 dhe 5, me rastin e përfundimit të mandatit të tij, nga pozitë: Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, i cili mandat i është përfunduar me Vendimin Nr.34/39 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 13.10.2021, me pas me Vendimin Nr.03/55 e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 21.01.2022, të cilën ankesë e ka plotësuar me parashtresën e datës 12.04.2022 me numër protokollit 2031/2022, duke pretenduar që ankuesit ti bëhet kthimi në listen e pagave nga data 13.10.2021.

Me datë 21.04.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil i Kosovës ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.28/2022 të protokolluar me numër 2304/2022 me të cilin janë bashkuar ankesat e ankuesit me numër A.nr.340/2022 e datës 06.04.2022 dhe ankesa me numër A.nr.1208/2021 të datës 21.12.2021, të parashtruara nga ankuesi për shkak se

ankesat bazohen në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, pasi që kjo e fundit është vendosur me datën 15.02.2022 me numër protokollit 790/2022 për pezullimin e procedurës administrative e filluar sipas Ankesës Anr.1208/2021 të datë 21.12.2021, nga Kolegji i Këshillit, dhe bashkimi i tyre në një ankesë e merr numrin e fundit të ankesës që është numëri A.nr.340/2022 i protokolluar me numër 1911/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në Ministria e Punëve të Brendshme dhe në Departamentin Menaxhimit të Zyrtarëve Publik -DMZP, e cila kërkesë i është përsëritur me datë 21.04.2022 përmes zyrtares së KPMSHCK-së me E-maili drejtuar zv.Drejtorisë së Përgjithshme të DMZP, në Ministria e Punëve të Brendshme, dhe e cila përmes Zyres së arkivit me E-mailin e datës 20.05.2022 ka bashkangjitur përgjigjen me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesë e datës 06.04.2022 ka parashtrua ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, me numër protokollit 1911/2022 e regjistruar me numër rendor A.nr.340/2022, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit nga Prishtina sipas Autorizimit të datës 21.10.2021; Kërkesë me numër protokollit 431-02 e datës 17.03.2022 drejtuar Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-DMZP; Aktit administrativ me numër protokollit 508-02 të datës 04.04.2022 të lëshuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik- DMZP; Plotësim i ankesës me datë 12.04.2022 me numër protokollit 1911/202 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimi Anr.82/2022 i datës 28.03.2022; Vendimi Anr.67/2022 i datës 07.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 17.03.2022 nr. protokollit 431/02 në DMZP; Sqarim i datës 04.04.2022 nr. protokollit 508/02 nga DMZP; E-mail i datës 21.04.2022 për DMZP për përgjigje ne ankesë të datës 06.04.2022; Vendimi Nr.16/35 i datës 09.03.2018 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimi Nr.34/39 i datës 13.10.2021 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimi Nr.13/59 i datës 21.01.2021 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Ankesë e datë 08.11.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, me numër protokollit 5329/2021, përmes postueses së Kosovës me numër postar R1922345, e regjistruar me Anr.1208/2021; Email i datës 18.11.2021; E-mail i datës 10.11.2021; E-mail i datës 07.11.2021; Përgjigje e datës 17.01.2021 me nr.protokollit 187/2022; E-mail kërkesë e datës 13.01.2022 me nr. protokollit 127/2022; Ankesë e datës 21.12.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, me numër protokollit 6251/2021; E-mail i datës 13.01.2022; E-mail i datës 21.10.2021; Vendimi Nr.28/2022 i datës 21.04.2022 për bashkim të lëndëve; E-mail i datës 20.05.2022 përmes Zyres së arkivit provat e bashkangjitur , shkresë e datës 21.04.2022, ofrim i dëshmimeve, Kërkesë me numër protokollit 431-02 e datës 17.03.2022, përgjigje e datës 04.04.2022 nga DMZP, me ankesat e parashtruara të përfaqësuesit të autorizuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka administruar provat e lëndës gjegjësisht ankesën me numër Anr.340/2022 të datës 06.04.2022 dhe ankesën me numër A.nr.1208/2021 të datës 21.12.2022, dhe poashtu ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit sipas

ankeses së plotësuar me parashtrësën e datës 12.04.2022 me numër protokolli 2031/2022, i cili kundërshton shkresën e fundit Sqarimin-administrativ të datë 04.04.2022 të nxjerrë nga zv.Drejtoresha e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB/DMZP, ankuesi pretendon që të sistemohet në pozitë të nivelit të mesëm drejtues, si dhe që të shqyrtohen dispozitat ligjore të përcaktuara në nenin 42 paragrafin 4 dhe 8 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, duke u ndërlidhur me nenin 53 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe me Vendimin A.nr.67/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës të datës 07.03.2022 me qëllim që të ndiqet standard i njëjtë në vendim marrje.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar shkresën e datës 04.04.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, ndërsa theksin e veçantë të arsyetimit të saj për shkak të mos realizimit të kërkesës së ankuesit të datës 16.03.2022, e bazon në nenin 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik pasi që në këtë rast dispozitat që garantojnë sistemimin e ankuesit janë të aplikueshme vetëm kur përmbushen parakushtet sipas paragrafit 4 dhe 5 të nenit 42 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Emërimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, sipas paragrafit 1 të këtij neni, bëhet për një kohëzgjatje 4-vjeçare me të drejtë një rizgjatje, për të njëjtnë pozitë pune, vetëm një herë dhe për të njëjtnë kohëzgjatje. 5. Rizgjatja e mandatit, në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, miratohet nga Qeveria, me propozim të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, duke u bazuar në performancën e tij. Propozimi bëhet të paktën 3 muaj para përfundimit të mandatit. Në rastin e institucioneve të tjera shtetërore, vendimi për rivazhdimin e mandatit merret nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë"* shtuar faktin kësaj së ankuesit nuk i ka mbaruar mandati në mënyrë të rregullt.

Kolegji, ndërlidhur me shkresën e datës 04.04.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB të lëshuar nga Zv. Drejtoresha për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik thekson faktin se përmbajtja e arsyetimit të shkresës së atakuar të pasqyruar si më lartë në këtë vendim, bie ndesh me dispozitat ligjore të përcaktuara si në nenin 83 paragrafin ku përcaktohet se: *"Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji"* pasi që sipas shkresës së atakuar statusi i garantuar i nëpunësit civil sipas kësaj dispozita ligjore i humbet, madje sqarimi i dhënë përmes shkresës së datës 04.04.2022 bie ndesh me nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*, pasi që ankuesit sipas shkresës së atakuar i cenohet e drejta e ruajtjes së statusit të fituar të nëpunësit civil.

Me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 53 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar se: *"1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj; 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në*

të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm”, andaj Kolegji konstaton se Vendimi Nr.03/55 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.01.2022, nuk ka pasoja në të kaluarën, rrjedhimisht nuk ka pasoja para datës së nxjerrjes së vendimit por vetëm në të ardhmen, nga rrjedh se ankuesi nuk mundet që ta ushtrojë më tutje pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, ndërsa i njëjti nuk e humbur statusin e nëpunësit civil, meqenëse vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk ka efekt retroaktiv-prapaveprues.

Andaj, në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përcaktohet se : *Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale”* dhe po ashtu në pajtim me nenin 15 paragrafi të Rregulloren Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku përcaktohet se: *“1. Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore e emëron nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale”,* Kolegji konstaton se meqenëse ankuesi e ka pasur të fituar statusin e shërbyesit civil deri në momentin kur ishte vendosur të shfuqizohet se Vendimi Nr.03/55 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.01.2022 për vazhdimin e mandatit të ankuesit, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB obligohet që ankuesin ta emërojë në cilën do pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale nën kuadër të Shërbimit Civil në administratën shtetërore.

Po ashtu, në pajtim me nenin 15 paragrafi 3 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku përcaktohet se: *“Gjatë periudhës së pritjes për emërim, tre (3) muajt e parë të kësaj periudhe pas përfundimit të mandatit, nëpunësi e merr pagën e pozitës të cilën e ka ushtruar deri në përfundim të mandatit dhe mund të konkurrojë për çdo pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, përveç asaj për të cilën i ka mbaruar mandati”,* Kolegji konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB është i obliguar t’ia kompensojë ankuesit pagesën sipas nenin 15 paragrafi 3 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues që nga data e pranimit të këtij vendimi deri në momentin e sistemimit, ndërsa afati për sistemimin e ankuesit rrjedh nga momenti i pranimit të vendimit të Këshilli.

Po ashtu, kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 130 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrini i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”,* ndërsa ankuesi përkundër faktit që me datë 08.11.2021 brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshill kundër vendimit me numër Nr.34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe me datë 26.01.2022 pas ri-shqyrtimit të lëndës së ankuesit i njëjti ka parashtruar sërish ankesë brenda afatit ligjor kundër vendimit me numër Nr.03/55 të datës 21.01.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i njëjti ka vazhduar ti vuaj prodhimin e pasojave juridike të akteve të lartcekura përmes të cilave ankuesi është larguar nga marrëdhënia e punës respektivisht i është ndaluar

paga, andaj mbi këtë bazë si dhe në mbështetje të nenit 130 paragrafi 1 dhe nenit 53 paragrafi 2 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstaton se Qeveria e Republikës së Kosovës është e obliguar t'ia bëjë ankuesit në mënyrë retroaktive kompensimin e pagave nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës sipas vendimit fillestar të datës datës 13.10.2021 me numër Nr.34/39 deri në momenti e zbatimit të këtij vendimi

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 53 paragrafi 2 dhe nenit 132 paragrafi 2 dhe 6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.340/2022

Zyle Millaku Goinovci
Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqsesit të autorizuar Avokatit
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës ;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Zyre të Kryeministrit ;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ;
- Drejtores në Departamentin për Menaxhinin e Zyrtarëve Publik në MPB/DMZP;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrin e Punëve të Brendshmes;
- Arkivat të KPMSHCK-së.